

Dalës-Izbezë

Nr. 1-17

Br.

OBILIQ-OPSTINA

Datë 12.02.2019  
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

Në mbështetje të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 61 të Statutit të Komunës së Obiliqit, caktoj:

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa me dt. 20.02.2019, (e mërkurë) në ora 10:00 në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2018
4. Shqyrtimi i Raportit të Zyres së Personelit për vitin 2018
5. Shqyrtimi i kërkesës së DSHPE-së, për objektet "D dhe GJ"
6. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për ndarjen e bursave, kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktoviteteve jashtëshkollore
7. Dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale
8. Propozim Vendimi për rritjen e të hyrave vetanake dhe bartja e mjeteve buxhetore nga viti 2018 në vitin 2019
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit  
*Burim Cërguari*  
Burim Cërguari  
REPUBLICA  
OBILIC-OPSTINA  
KOSOVO



Datë-izazma

Nr. 1-16

Br.

Data 12.02.2019  
Datum

OBLIQ-OBLIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obilić - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt. 25.01.2019, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm janë këta anëtarë:: Burim Gërguri, Florije Jashari, Linda Sadiku, Hysni Mjeku, Fatos Kurshumlija dhe Slavisa Spasic

Të pranishmit tjerë: Ibush Mjekiqi, Nënkyrytar i Komunës, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, përf. i OSBE-së, përf. i IZHL-së  
Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës të Kuvendit komunal për vitin 2019
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.  
Aprovohet njëzërit rendi i ditës, i cekur më lartë.

1. Pika e parë e rendit të ditës –  
Mungoi: Qëndresa Dubova me arsy

2. Pika e dytë e rendit të ditës –  
Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

3. Pika e tretë e rendit të ditës –

**Burim Gërguri** – Prezentoi Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2019 në mënyrë të detajuar.  
Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

### R E K O M A N D I M

I rekomandohet Kuvendit komunal për shqyrtim dhe aprovim Planit i Punës i Kuvendit Komunal për vitin 2019.

4. Pika e katërt e rendit të ditës –

**Burim Gërguri** – E paraqiti kërkesën nga Fanol Shala, fshati Shkabaj për infrastrukturë shtesë me rastin e vdekjeve.

**Hysni Mjeku** – Mendoj se kjo kërkesë është shumë me vend dhe kërkon trajtim të menjëherëshëm me përjashtim tash koha nuk është e përshtatshme, por mbi të gjitha nga muaji mars e tutje duhet të punohet në këtë drejtim. Sa i përket lokalit meqenëse, atje është komplet një lagje e dislokuar dhe pasi që shumica e fshatrave kanë bërë një zgjidhje, besoj se Kuvendi komunal me trajtimin e buxhetit në periodat e ardhshme ka mundësi përafërsisht 10,000-15,0000 euro ti ndajë nëse, bëjmë lëvizje të projekteve që s'kanë urgencë. Te çështja e pikave që u cekën, unë besoj se anën teknike profesionale Kuvendi komunal duhet ta kryej me kohë qytetarë mos ti lëndojmë dy herë sepse ata edhe ashtu veç kanë qenë të lënduar, prandaj unë e përkrah vjë kërkesë të tillë.

Pas diskutimeve, kjo kërkesë shkon për shqyrtim te Ekzekutivi i Komunës.

**Burim Gërguri** – E paraqiti kërkesën nga nga banorët e fshatit Grabofc të Epërm për emërtimin e rrugës së re me emrin e martirit “Behxhet Ajet Mjekiqi”.

**Hysni Mjeku** – Në parim krejtë që ka është thënë në kërkesë qëndrojnë aty, por te çështja e emërimit të rrugëve, ne e kemi pasë një Komision më heret dhe nëse lejojnë parametrat atëherë pse të mos emërohet edhe një rrugë në lagjen tonë aty. Mendoj se duhet të përfshihen edhe ato kritere të cilat janë të rregulluara me ligj, do të thotë jam pro edhe besoj se do ti bëjmë ndër edhe martirit njëkohësisht edhe familjes.

**Burim Gërguri** – Ju e dini se emërimi i rrugëve ka përfundue në vitin 2015 dhe ne prej DPUKP-së, mund të kërkojmë se a ka nevojë me nxjerrë kod të ri apo si është zgjidhja. Nëse, ka hapësirë ligjore ne si Kuvend komunal i kemi respektue dhe jemi për me i respektue këto vlera. Unë jam pro kësaj kërkesë dhe ju e dini se është një Komision komunal dhe emërimi e riemërimi i rrugëve ka qenë për 10 vite, prandaj kjo kërkesë pse nuk është trajtue në atë kohë, unë nuk e di. Ne duhet ti shohim të gjitha mundësitë ligjore të cilat nuk e cënojnë vendimin e ish Komisionit të vitit 2015.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, unanimisht morën këtë:

#### REKOMANDIM

I rekomandohet DPUKP-së për shqyrtim kërkesa nga banorët e fshatit Grabofc të Epërm për emërtimin e rrugës së re me emrin e martirit “Behxhet Ajet Mjekiqi”.

**Burim Gërguri** – E paraqiti kërkesën nga Sabile Mehmeti nga Mazgiti, e cila kërkon ndihmë financiare për trajtim mjekësor.

Pas diskutimeve, kjo kërkesë shkon për shqyrtim në DSHMS.

**Burim Gërguri** – Paraqiti edhe 2 kërkesa tjera të cilat kanë ardhë pas dërgimit të materialit për KPF, njëra është kërkesa nga DSHPE-ja, për lokalet në objektin “D dhe GJ” tjetra nga Bashkim Ismaili, nga LLazareva.

**Hysni Mjeku** - Kërkon meqë, këto kërkesa kanë ardhë me vonësë, të mbeten për shqyrtim në mbledhjen e radhës të KPF-së.

Pas diskutimeve, këto kërkesa mbeten të shqyrtohen në mbledhjen e ardhshme të KPF-së.

#### 5. Pika e pestë e rendit të ditës

**Burim Gërguri** – Dua ta ngriti një shqetësim duke pasë parasysh se është java e dytë që po e humbim procesin mësimor pothuajse, në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Në disa shkolla ka fillue mësimi ndërsa, në disa jo sinqerisht ne jemi në gjendjen më të vështirë ku fëmijët janë duke pësuar më së shumti. Ne në parim i kemi mbështetë si grevistë, por forma e protestës ndoshta kishte me qenë mirë të ishte ndryshe sepse më së shumti po pësojnë fëmijët tonë.

**Avdyl Mustafa** – E pyeti kryesuesin se rekomandimet e Komitetit për komunitete, a do ti paraqitni në KPF, apo direkt në Kuvendin komunal..

**Burim Gërguri** – Përgjegjet se në mbledhjen e radhës të Kuvendit komunal do ti shqyrtojmë.

**Hysni Mjeku** – Meqenëse, jemi organ i Kuvendit komunal, besoj se çështja e grevës dhe Arsimit fillor që bie në domenin e Kuvendit komunal, duhet trajtuar dhe duhet të jetë kogja brengosëse. Këtu, ka vend për kritikë për dy pjesët e medaljes edhe Qeveria dhe Sindikata, por besoj se do të gjendet një vendim i përshtatshëm për të dy palët, që e hëna të jetë ditë pune për të gjithë dhe të mos kemi probleme përmbarëvajtje. Fundja e fundit ne jemi të thirrur me i zbatue të gjitha të drejtat që na takojnë dhe mbi të gjitha prioritet duhet të jetë fillimi i procesit mësimor sepse çdo zvarritje është në dëm të nxënësve.

**Burim Gërguri** – Ne kur e kemi aprovue buxhetin në vitin 2018 për vitin 2019, jemi organi më i lartë që kemi marrë vendim edhe për pagat e arsimtarëve dhe një kërkesë e tillë nuk ka qenë në atë kohë. Ndoshta, është vendim i Qeverisë me ritë koeficientë, por ato ritje as ne nuk i kemi aprovue as në administratë, as në shëndetësi, as nëndonjë nivel tjetër të reformës. Uroj që të bëhet një zgjidhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50

Bashk.prof.për punë të KK-së

Azize Zeneli



Kryesuesi i KPF-së

Burim Gërguri